

Ftesë për Shprehje të Interesimit

Data: 13.06.2023

Nr. KDF/IC/2023-01

Emri i kontrates: Konsulent vendor për hartimin e Strategjisë pesë vjecare të Organizatës Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

1. Rreth organizatës

Forum i Kosovari i Aftësisë së Kufizuar është organizatë jofitimprurëse ombrellë dhe mekanizëm përfaqësues i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, e cila përfaqëson, mbrojnë dhe promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të unifikuar dhe pa asnjë dallim.

Termat e Referencës

2. Objektivi

Forum i Kosovari i Aftësisë së Kufizuar synon të angazhojë një konsulent të specializuar për hartimin e dokumentit strategjik të institucionit

3. Shërbimi që duhet të ofrohet

Hartimi i Strategjisë pesë vjecare të institucionit Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

4. Përvoja dhe shkathtësitë e nevojshme

Konsulenti/ja duhet t'i ketë kualifikimet dhe shkathtësitë thelbësore të mëposhtme:

- Diplomë pas universitare (preferohet grada Master në ndonjë fushë të ndërlidhur me shkencat shoqërore).
- Njohja e mirë e funksionimit të organizatave jo qeveritare dhe sistemit të menaxhimit të tyre (trajnimet në këtë fushë konsiderohen përparësi).
- Përvojë e punës në fushën e aftësisë së kufizuar.
- Përvojë paraprake në realizimin e dokumenteve strategjike organizative të natyrës se ngjashme;
- Aftësi për të hartuar raporte koncize dhe me cilësi të lartë, në format të kuptueshëm për lexuesin, duke shfaqur shkathtësi të shkëlqyeshme analitike;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe prezantimit para audiencave me njohuri
- dhe shkathtësi të ndryshme teknike;
- Kreativ, i/e hapur për konsultime dhe pranon sugjerime;
- Aftësi për të ju përmbajtur planeve të punës.

5. Afatet kohore

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Ditët e punës	Afatet Kohore
1	Analiza e kontekstit të fushës	2	Qershor
2	Takimi për marrjen e inputeve fillestare	1	Qershor
3	Hartimi i objektivave strategjike	2	Korrik
4	Takimi i dytë për prezantimin e objektivave dhe marrjen e komenteve	1	Korrik
5	Konsultime me palët e interesit	3	Korrik-Shtator
6	Hartimi i strategjisë	7	Korrik-Shtator
7	Takimi i tretë për prezantimin e strategjisë dhe marrjen e komenteve	1	Shtator
8	Adresimi i komenteve dhe finalizimi i strategjise	2	Shtator
Total ditë pune		19	

6. Si të aplikoni?

Kandidatët e interesuar janë të mirëseardhur të aplikojnë duke dorëzuar dokumentacionin e listuar më poshtë, në emailin prokurimi@kdf-ks.org me subjekt: **Konsulent/e për të hartuar strategjinë institucionale**. Në aplikim duhet të përfshini:

- b) Curriculum Vitae (CV).
- c) Metodologjia dhe plani i veprimit
- d) Dëshmi të tjera të eksperiencës në fushën e ngjajshme

Pas krahasimit, dhe vleresimit nga komisioni të dokumenteve të pranuar, kandidatit me numrin me të larte të poenave do ti kërkohej oferta financiare.

Kriteret e vlerësimit	Pikët
Kualifikimi/Niveli i arsimimit	40
Metodologjia dhe plani i veprimit	30
Përvoja e mëhershme për shërbime të ngjajshme	30
Total	100

Afati i fundit për aplikim është: 26.06.2023 deri në ora 16:00 në email adresën prokurimi@kdf-ks.org

Dokumentet e derguara pas afatit të caktuar nuk do të pranohen.